



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 64

13 qershor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Page
Vendim i Kuvendit nr.23/2012 datë 11.6.2012	Për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.....	3143
Dekret nr. 7503 datë 1.6.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3143
Vendim i KM nr. 313, datë 9.5.2012	Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e publikut nga shkarkimet në mjedis, përcaktimin e mostrave, rajoneve dhe frekuencës së matjeve”.....	3144
Vendim i GJK nr. 33, datë 24.5.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr.19, datë 07.05.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; të vendimit nr.50, datë 01.11.2007 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe të vendimit nr.394, datë 08.07.2009 të Gjykatës së Lartë.....	3147
Vendim i GJK nr. 34, datë 28.5.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.06.1997 “Për përfitim nga statusi i të verbrit”, ndryshuar me VKM-të nr.870, datë 18.06.2008 dhe nr.602, datë 23.07.2010.....	3154
Vendim i GJK nr. 35, datë 30.5.2012	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.....	3162
Udhëzim i KMDHP nr. 17, datë 11.5.2012	Mbi përcaktimin e kohës së mbajtjes së të dhënave personale që përpunohen në sistemet elektronike, nga organet e Policisë së Shtetit për qëllime parandalimi, hetimi, zbulimi dhe ndjekje të veprave penale.....	3166



VENDIM
Nr. 313, datë 9.5.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MBROJTJEN E PUBLIKUT NGA SHKARKIMET NË MJEDIS, PËRCAKTIMIN E MOSTRAVE, RAJONEVE DHE FREKUENCËS SË MATJEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për mbrojtjen e publikut nga shkarkimet në mjedis, përcaktimin e mostrave, rajoneve dhe frekuencës së matjeve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E PUBLIKUT NGA SHKARKIMET NË MJEDIS, PËRCAKTIMIN E MOSTRAVE, RAJONEVE DHE FREKUENCËS SË MATJEVE

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton kushtet e mbrojtjes së publikut dhe mjedisit, në tërësi nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve jonizuese me qëllim mbrojtjen e shëndetit të publikut.

Neni 2
Monitorimi i radioaktivitetit

1. Monitorimi i radioaktivitetit të mjedisit nënkupton matje bazë të cilat lidhen me përqendrimin e radionuklidëve në ajër, ujë dhe tokë. Për të realizuar një përputhje të mirë me standardet bazë të sigurisë, përveç radioaktivitetit të ajrit, ujit dhe tokës të përcaktohet edhe niveli i radioaktivitetit të mostrave biologjike dhe në veçanti të ushqimeve.

2. Ekspozimi i popullatës që vjen nga radioaktiviteti i mjedisit vlerësohet në mënyrë më direkte dhe të plotë në bazë të ndotjes së ushqimeve. Monitorimi i mjedisit përfshin dhe monitorimin e niveleve të radioaktivitetit të biotave të ndryshme si ushqimi për njerëzit, ushqimi për kafshët, si dhe vetë bimësia.

3. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave mbi bazën e të dhënave që i japin institucionet monitoruese publikon çdo vit një raport monitorimi.

4. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi me propozim të institucioneve monitoruese, si dhe duke ju referuar raportit vjetor të monitorimit dhe problematikave në mjedis përcakton llojet e mostrave dhe të radionuklideve që duhet të monitorohen dhe që janë tregues të niveleve aktuale dhe potencialeve të radioaktivitetit në mjedis, që ndikojnë në ekspozimin e popullsisë.

5. Këto nivele monitorimi në mjedis janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga Ministria e Mjedisit nëpërmjet institucioneve monitoruese.

Neni 3 Rrjeti monitorues

1. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi me propozim të institucioneve monitoruese përcakton rajonet përfaqësuese gjeografike për territorin e vendit që do të bëjnë pjesë në rrjetin e monitorimit. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi përcakton për çdo tip mostre një rrjet monitorimi të dendur dhe të rrallë sipas një frekuence të caktuar.

2. Institucionet monitoruese janë persona fizikë juridikë ose fizikë të njohur nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi të cilët kanë kapacitetet teknike dhe pajisje për të kryer monitorimin e mjedisit bazuar në kriteret e miratuara dhe publikuara më parë prej KMR-së.

3. Institucionet monitoruese paraqesin pranë Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi të gjithë procedurën e monitorimit dhe kampionimit. Kjo procedurë vlerësohet dhe aprovohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.

4. Rajonet që përbëjnë rrjetin monitorues të përfaqësojnë situatën rajonale, të marrin parasysh shpërndarjen e popullsisë dhe të aktivitetëve prodhuese në atë rajon.

Neni 4 Llojet e mostrave, tipat e matjeve dhe periodicitetit

1. Llojet e rekomanduara të mostrave dhe të matjeve janë si më poshtë:

Lloji i mostrës	Lloji i matjeve	
	Rrjet monitorimi i dendur (mujore)	Rrjet monitorimi i rrallë (tremujore)
Aerozole	Cs-137, beta total	Cs-137, Be-7
Ajër	Fuqia e dozës gama mjedisore	Fuqia e dozës gama mjedisore
Ujë sipërfaqësor	Cs-137, beta total	Cs-137
Ujë i pijshëm	H-3, Sr-90, Cs-137 Radionuklidet natyrore	H-3, Sr-90, Cs-137 Radionuklidet natyrore
Qumësht	Cs-137, Sr-90	Cs-137, Sr-90, K-40
Dietë e përzier	Cs-137, Sr-90	Cs-137, Sr-90, C-14

2. Rekomandohet që për rrjetet monitoruese të dendura matjet të kryhen çdo muaj, ndërsa për ato të rralla çdo tre muaj.

Neni 5 Strategjia e marrjes së mostrave dhe matjet në lidhje me çdo lloj mostre

1. Marrja e mostrave bëhet në mënyrë të tillë që të na paraqesin një vlerësim sa më të plotë të radioaktivitetit në mjedis. Këto mostra përfshijnë:

a) Aerozole

Për aerozolet kryhen në mënyrë rutinore matja e radionuklidëve gama emetuese artificiale dhe natyrore. Institucionet monitoruese raportojnë gjithashtu rezultatet e matjeve beta totale dhe ato për beriliumin-7. Vendet e marrjes së mostrave duhet të zgjidhen pranë zonave me popullsi të dendur me një mbulim gjeografik sa më të mirë të territorit duke zgjedhur të paktën një vend për marrjen e mostrave në një rajon gjeografik.

b) Ajër

Lidhur me ajrin kryhen matje të vazhdueshme për fuqinë e dozës gama mjedisore.



c) Ujë sipërfaqësor

Marrja e mostrave kryhet për ujërat e brendshme kryesore dhe për ujërat bregdetare.

Në rastin e ujërave të lumenjve, mostrat merren në zonat ku njihet debiti (prurja) e rrjedhjes. Për këto mostra kryhet monitorimi i radionuklidëve gama emetuese dhe i matjeve beta totale.

d) Ujë i pijshëm

Institucionet monitoruese raportojnë vlerat për furnizuesit kryesorë të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe për rrjetet e shpërndarjes së ujit. Pikat e marrjes së këtyre mostrave duhet të jenë të tilla që të mbulojnë në mënyrë përfaqësuese rajonin.

Gjithashtu të raportohet vlera korresponduese e volumit të ujit të shpërndarë ose të prodhuar gjatë një viti për secilën pikë të marrjes së mostrës.

e) Qumësht

Mostrat e qumështit duhet të merren nga pikat e prodhimit, si dhe të raportohet edhe sasia e prodhuar nga secila pikë. Pikat e marrjes së këtyre mostrave duhet të jenë të tilla që të mbulojnë në mënyrë përfaqësuese rajonin. Monitorimi duhet të përfshijë matjet Cs-137, Sr-90 dhe K-40.

f) Dietë e përzier ushqimore

Matja e dietës së përzier ushqimore është një indikator shumë i rëndësishëm i ekspozimit të popullatës. Për të përcaktuar radioaktivitetin e dietës së përzier mund të përcaktohet radioaktiviteti i përbërësve të saj ose i një racioni të zakonshëm ushqimor.

Monitorimi i dietës së përzier përfshin emetuesit gama dhe Sr-90. Ky monitorim duhet të kryhet për intervale 3-mujore.

Neni 6

Rekomandime bazë për monitorimet sipas mostrave, matjeve dhe frekuencave

1. Komisioni i mbrojtjes nga rrezatimi bazohet në rekomandimet e mëposhtme për monitorimet sipas mostrave, matjeve dhe frekuencave. Këto monitorime komisioni i mbrojtjes nga rrezatimi i miraton të paktën çdo 5 vjet, por dhe më shpesh kur ka ndryshime mjedisore. Monitorimet sipas mostrave janë si më poshtë:

a) Mostra për aerozolet

Gama: Cs-137, Pb-210, K-40, Be-7 (çdo muaj)

Total alfa-beta

Alfa: U-238, U-234, Pu-239 dhe 240

b) Mostra depozitimi ose precipitimi (Fall-out) nga shirat dhe pluhurat nga atmosfera

Gama: Cs-137, Pb-210, K-40, Be-7 (çdo muaj)

Total alfa-beta (çdo muaj)

c) Mostra Bari

Gama: Cs-137, K-40 (dy herë në vit)

d) Mostra toke

Gama: Cs-137, K-40, Ra-226, Th-232 (dy herë në vit)

Beta: Sr-90 (dy herë në vit)

Alfa: U-238, U-234, Pu-239+240 (dy herë në vit)

e) Mostra ujë i pijshëm

Alfa: U-238, U-234, Po-210 (dy herë në vit)

Total alfa-beta (katër herë në vit) Rn-222 (për nivele mbi 40 Bq/l, tri herë në vit dhe për nivele nën 40 Bq/l, një herë në vit)

ë) Mostra qumështi

Gama: Cs-137, K-40 (dy herë në vit)

Beta: Sr-90 (dy herë në vit)

- f) Matjet në ajër
- Fuqia e dozës së rrezatimit gama në ajër (matje ditore)
- g) Dieta e përzier ushqimore
- Gama: Cs-137 (dy herë në vit)
- Beta: Sr-90 (dy herë në vit)

Neni 7

Rrjeti kombëtar i monitorimit të radioaktivitetit

1. Referuar shpërndarjes së popullatës dhe aktiviteteve prodhuese në raport me monitorimin e radioaktivitetit në mjedis, vendi ynë ndahet në tre rajone përfaqësuese:
 - a) Rajoni i Shqipërisë Veriore;
 - b) Rajoni i Shqipërisë së Mesme;
 - c) Rajoni i Shqipërisë Jugore.
2. Për secilin rajon përcaktohen pikat e kampionimit si më poshtë:
 - a) Rajoni i Shqipërisë Veriore përfshin Shkodrën dhe Kukësin;
 - b) Rajoni i Shqipërisë së Mesme përfshin Tiranën Durrësin dhe Elbasanin;
 - c) Rajoni i Shqipërisë Jugore përfshin Vlorën, Gjirokastrën dhe Korçën.
3. Për Tiranën të përcaktohen dy pika kampionimi, kurse për qytetet e tjera të përcaktohet një pikë kampionimi.

VENDIM

Nr. 33, datë 24.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	Anëtar i “ “
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “

me sekretare Elta Milori, në datat 15.12.2011 dhe 22.12.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr. 52/27 Akti, që i përket:

KËRKUES: Fredi Aliaj, përfaqësuar nga avokat Theodhori Sollaku, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr.19, datë 07.05.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; i vendimit nr.50, datë 01.11.2007 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe i vendimit nr.394, datë 08.07.2009 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës; neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenet 48, 49, 50/1, 74, 75/a, 83/1 të Kodit të Procedurës Penale.